



Pranuar / Dorezuar Punë/eno/Pridato Received/Delivered	28.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPANSHUK	5824/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.960/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.960/2023 të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër 08/2023 të datës 05.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.960/2023 e datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.8/2023 i datës 05.07.2023 i Udhëheqëses për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

A r s y e t i m

Komisioni Kombëtar për Klasifikim pas pranimit të kërkesave urgjente nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Shëndetësisë, respektivisht nga Inspektoratet në kudër të këtyre ministrive dhe kërkesave nga inspektoratet tjera te natyrës se njëjtë, me date 18.04.2023 kanë parashtruar propozimin për formimin e grupeve për klasifikim të vendeve të punës tek Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.



Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme ne pajtim me nenin 28 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, me datë 19.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër NR.1001/2023, me te cilin ka aprovuar kërkesën e verifikuar edhe nga

Komisioni Kombëtar për Klasifikim për krijimin e grupeve ad hoc për pozitat e punës : Specialist i Përgjithshëm për Inspektim dhe Specialist i Posaçëm për Inspektim. Me Vendim me numër NR.1001/2023 të datës 19.04.2023 janë përcaktuar kriteret e kualifikimit për këto dy grupe dhe njëkohësisht është përcaktuar se këto dy grupe të themeluara sipas Vendimit me numër NR.1001/2023 të datës 19.04.2023 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshëm i bashkëngjiten Shtojcës dy (2) të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 26.04.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Referencës: RN00011534 për grupin Specialistë të Përgjithshëm për Inspektim respektivisht për pozitën *Inspektor i Punës*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 17.05.2023 deri më datë 27.05.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ku përmes Vendimit me Nr.34/2023 të datës 27.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmim e përvojës së punës së punës prej dy (2) vite si dhe kopjen e dëshmisë te trajnimit, ashtu siç është kërkuar ne konkurs.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr. 8/2023 të datës 05.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankuses, me arsyetim se e njëjta nuk ka arritur te dëshmoj përvojën e punës si dhe dëshminë e trajnimeve ashtu siç ishte kërkuar ne piken 7 te konkursit.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.8/2023 të datës 05.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 5211/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli me datë 20.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova:** Ankesën e datës 14.07.2023 te parashtruar nga ankuesja ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës; Konkursin e datës 26.04.2023; Aplikacionin e ankuses; Diplomën universitare me Nr.D-19/2019 të datës 14.06.2019; Trusi- Pasqyra e Llogarisë bankare; Vërtetimin me numër 4289 të datës 24.05.2023; Vërtetimin ( pa date dhe numër) te lëshuar nga Menaxheri i Perosnelit ne Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve; Certifikatën mbi



dënimet penale të datës 19.05.2023; Vendimin me numër 34/2023 të datës 27.06.2023; Emalin e datës 04.05.2023 të drejtuar H.Nikçi; Ankesën e datës 29.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Certifikatën e datës 09.04.2015 të lëshuar nga Kolegji Evropian Juridika; Certifikatën e datës 07.12.2016 të lëshuar nga MDA; Shkresën lidhure përmbledhjen e trajnimeve të ankueses; Vendimin me numër 8/2023 të datës 05.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 18.07.2023; Përgjigjenin në ankese të datës 20.07.2023; Listën e aplikantëve me numër reference RN00011534; Listën e ngushtë të datës 27.06.2023; Plotësimin ndryshimin e listës së ngushtë të datës 05.07.2023; Aplikacionin e ankueses; Vendimin me numër 06/151 të datës 12.07.2023 për themelimin e Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm për Inspektim; Vendimin me numër 1001/2023 të datës 19.04.2023 të Ministrisë të Punëve të Brendshme; Propozimi për formimin e grupeve për klasifikim të vendeve të punës të datës 19.04.2023; Emalin e datës 02.08.2023; Emalin e datës 22.08.2023

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.8/2023 të datës 05.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se e njëjta me rastin e aplikimit ka bashkëngjitur trajnimet si dhe përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit, në bazë të vlerësimit të provave, ka konstatuar se sipas konkursit me numër reference RN00011534 me emrin e grupit „Specialist i Përgjithshëm për Inspektim“, për pozitën e punës „Inspektor i Punës“ në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Mitrovicës në Inspektoratin e Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në pikën 3 si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar:

*Diplomë e arsimit të lartë më së paku tre (3) vite të studimeve. Fakulteti Juridik, Ekonomik, Shkenca Politike, Siguri Publike, Shkenca Sociale, dhe Edukim; si dhe*

- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa në pikën 7 të këtij konkursi janë përcaktuar dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim :

- *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit;*
- *Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;*
- *Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;*
- *Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;*



- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, Është ne sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar gjashtëdhjetë e tre (63) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja por e cila me datë 27.06.2023 përmes Vendimit me numër Nr.34/2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është njoftuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, ngase e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit gjegjësisht e njëjta nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës prej dy (2) vite të mbuluara me trust ne sektorin privat dhe kopjet e dëshmive te trajnimit ashtu siç është kërkuar në konkursin me numër reference RN00011534.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.8/2023 të datës 05.07.2023 për refuzimin e ankesës së saj lidhur mos përfshirjen në listën e ngushtë sepse aplikimi nga ana e saj është kryer në përputhje me kërkesat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit të njoftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, Kolegji pas analizimit të dosjes së aplikimit të ankueses dhe organit të punësimit ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të kualifikimit shkollor dhe përgatitjes së përvojës së punës posedon: Diplomë Universitare me numër Nr.19/2019 të lëshuar nga Kolegji Evropian „Juridica“ më datë 14.06.2019 me të cilën dëshmohet se ankuesja i ka përfunduar studimet ne programin Politikat Publike dhe Menaxhment me datë 01.06.2019 dhe mori titullin “Bachelor i Arteve në Politika Publike dhe Menaxhment”, si dhe me përvojë të punës si në vijim: sipas Vërtetimit të datës 24.05.2023 të lëshuar nga Departamenti i Pensioneve-Zyra Rajonale e Pensioneve në Mitrovicë me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar punën praktike pa pagese nga data 17.04.2017 deri më date 16.10.2017 dhe Vërtetimin pa datë dhe numër të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës me të cilën dëshmohet se ankuesja është angazhuar si praktikante në Inspektoratin e Punës nga data 20.12.2022 deri me datën 20.12.2023, gjegjësisht ne Vërtetim ceket se „*deri me tani ka 4 muaj e 15 dite dhe vazhdon te jete deri me date 23.12.2023*“, si dhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional të Kosovës për periudhën 18.05.2022 deri më 18.05.2023, andaj në bazë të dëshmive të ofruara Kolegji ka vërtetuar se kandidatja nuk ka arritur të dëshmoj përvojën e punës prej dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës“ ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ne baze te dëshmive të ofruara ka konstatuar se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesja, ka bërë vlerësimin paraprak në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.





16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesja me Vendimin me numër Nr.34/2023 të datës 27.06.2023 është njoftuar se e njëjta nuk i plotëson kriteret e konkursit me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi që vërtetojnë përvojën dhe pozitën e punës që është ushtruar prej dy (2) vite të mbuluar me trust ne sektorin privat, ngase në konkurs është kërkuar së paku (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësim të pozitës së lirë të punës, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja ka dorëzuar dëshminë gjegjësisht Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional të Kosovës për periudhën 18.05.2022 deri më 18.05.2023, sipas të cilës rrjedh se ankuesja ka punuar te Kompania „Fitimi Construction“, mirëpo e njëjta nuk ka bashkangjitur dëshmi si kontratë të punës apo vërtetim punësimi nga institucioni përkatës, me të cilat dëshmohet saktë periudha e përvojës së punës dhe pozita të cilën e ka ushtruar dhe për çfarë periudhe kohore ka punuar në atë pozitë. Andaj mbi bazën e këtyre fakteve dhe duke marr parasysh Aktvendimin me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Kolegji rithekson faktin se kriteri i përvojës së punës duhet të dëshmohet përmes kontratës punës dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës.

Andaj, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara, respektivisht dëshmitë e dorëzuara nga ankuesja me rastin e aplikimit, konstaton se e ankuesja nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale përvojën e punës, rrjedhimisht sipas normave ligjore e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, rrjedhimisht Kolegji konstaton se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.34/2023 të datës 27.06.2023 si dhe Vendimit me numër Nr.8/2023 të datës 05.07.2023 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankuseses ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“ Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak..5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin”* ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 dhe paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Po ashtu Kolegji konstaton se Vendimi është arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj mbi këtë mbi këtë bazë pretendimi i ankuseses se e njëjta i ka plotësuar kushtet e konkursit për sa i përket përvojës së punës është i pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.960/2023*

Ilire **MEHMETI-SHAQIRI**

*Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional*

Malsore **GASHI-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publikë në MPB, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.